

ALGJEBËR DHE GJEOMETRI

Kodi i lëndës	Semestri	Kreditet e lëndës				Kredite
		Leksione	Ushtime/ Seminare	Lab.	Detyra	
B-ELN-105	I	3	3	-	-	6
Sasia e orëve: auditor/jashtë auditorit		36/39	42/33	-	-	78/72
Sasia e orëve: Total		75	75	-	-	150

Titullari i lëndës: Adrian Naço, Doktor

Objektivat e lëndës

Lënda ka për qëllim të japë njojuritë bazë, të organizuara sipas kuptimeve, ideve e metodave të algjebërës së sotme, nga hyrja në logjikën matematike, nga strukturat algjebrike themelore, nga algjebla lineare, duke u ndalur në sistemet e ekuacioneve lineare dhe metodat e zgjidhjeve të tyre, në hapësirat lineare veçanërisht në hapësirat euklidjane dhe pasqyrimet lineare të tyre, në autovlerat dhe autovektorët e endomorfizmave e në diagonalizimin e tyre, si dhe në format lineare dhe ato katrore. Gjithashtu të japë njouri bazë nga gjeometria analitike në plan dhe në hapësirë, duke i ndërtthurur ato me njojuritë algjebrike.

Përbajtja

Elemente të logjikës matematike. Relacionet: Lidhjet dyshe. Funksioni injektiv, syrjetiv, pasqyrimi, bijekzioni. Funksioni dhe pasqyrimi i anasjellë. Veprimi algjebrik, vjetitë. Strukturat algjebrike me një veprim dhe me dy veprime. Homomorfizmat. Hapësira dhe nënhapësira lineare mbi një fushë. Hapësira lineare e vektorëve gjeometrikë. Projekzioni kënddrejtë i vektorit mbi bosht. Sistemet e koordinatave karteziiane të pikës dhe vektorit. Sistemi polar. Shumëzimi numerik. Shumëzimi vektorial dhe ai i përzjerë i vektorëve. Fusha e numrave kompleksë. Trajta algjebrike. Numri kompleks i konjuguar. Trajta trigonometrike, formula e Muavrit, nxjerja e rrënjes, trajta eksponenciale, formula e Ejlerit. Polinomet. Hapësira lineare e polinomeve. Unaza e polinomeve. Zerot e polinomeve dhe zeronët në $R[x]$. Hapësira lineare e vektorit me n përmasa. Bazat. Izomorf. me F^n . Hapësira euklidiane, mosbarazimi i Shvarcit, baza e ortonormuar, procesi i Gram-Shmidtit. Sistemet e ekuacioneve lineare. Metoda e Gaussit. Hapësira lineare e matricave. Unaza e matricave katrore. Përcaktorët dhe vjetitë e tyre. Matrica e anasjellë. Shndrimi i bazës në H_n . Rangu i matricave. Zgjidhja e sistemeve me anë të matricave. Teorema e Kramerit dhe ajo e Kroneker-Kapelit. Metoda e Gauss-Zhordanit për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare. Pasqyrimet lineare. f , $\text{Im } f$ dhe matrica shoqëruese e një pasqyrimi linear f . Pasqyrimi. $F^n \rightarrow F^m$ Shndrimi i matricës shoqëruese të pasqyrimit linear. Endomorfizmat. Autovlerat e autohapësirat. $F^n \rightarrow F^n$ Diagonalizimi i endomorfizmave dhe i matricave katrore reale. Zgjidhja e sistemeve të ekuacioneve diferenciale lineare të rendit të parë me anë te autovlerës të matricës së tij. Endomorfizmat ne R^n . Matrica ortogonale. Izometria, endo. ortogonal dhe ai simetrik. Gjeometria analitike në plan. Ekuacioni karteziian e polar i vijës. Ekuacioni parametrik. Vijat algjebrike. Drejtëza. Konike. Ekuacioni polar i konikes. Përdorimi i formës katrore në klasifikimin e vijave të fuqisë së dytë. Gjeometria analitike në hapësirë. Ekuacioni i sipërfaqes. Ekuacionet karteziiane dhe ato parametrike të vijës. Plani. Ekuacionet karteziiane, kanonike dhe ato parametrike të drejtëzës. Sipërfaqet cilindrike, konike, rrotulluese. Sipërfaqe të fuqisë së dytë: elipsoidi, hiperboloidi me një dhe dy napa, paraboloidi eliptik dhe hiperbolik.

Literatura e rekomanduar për lëndën

Sh. Kuka & A. Naco, *Algjebra Lineare dhe Gjeometria Analitike*; 2016

D.R.Hill & D.E.Zitarelli, *Linear Algebra Labs with MATLAB*; 2004

K.H.Rosen, *Discrete Mathematics and Its Applications*; 2012

K. Filipi, *Algjebra dhe Gjeometria*, 2005, shblu; ribotim 2011;